

## ÇFARË MUND TË BËSH NËSE MENDON SE:

- ◆ punëdhënësi ka shkelur ndonjë nga detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata kolektive,
- ◆ punëdhënësi të ka dorëzuar shkarkim të paligjshëm nga puna ose të ka çregjistruar nga sigurimi social i detyrueshëm pa tu dorëzuar vendimi i shkarkimit nga puna
- ◆ je viktimë e ngacmimit në vendin e punës (mobingu)
- ◆ nuk ke kushte të sigurta për punë
- ◆ keni kërkesa parash të papaguara nga marrëdhënia e punës

## TË DREJTOHESH TE KOMITETIN E HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË:

Rr. Naum Naumovski Borçe Nr. 83 - Shkup  
Numrat e kontaktit: +38923119073 dhe +38972278436  
Posta elektronike/e-mail: helkom@mhc.org.mk

## KOMITETI I HELSINKIT PER TE DREJTAT E NJERIUT QYTETAREVE JU OFRON NDIHME PRIMARE JURIDIKE FALAS

### Me ndihmën juridike parësore-primare merrni:

- ✓ Informacion të përgjithshëm juridik;
- ✓ Këshillë të përgjithshme juridike;
- ✓ Ndhimë në plotësimin e formularëve;
- ✓ Ndhimë në plotësimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore-sekundare;
- ✓ Ndhimë në përgatitjen e kundërshtimeve dhe kërkesave të tjera drejtuar punëdhënësit;
- ✓ Paraqitja e ankesave pranë Inspektoratit Shtetëror të punës dhe ndjekja e të gjithë procedurës për mbrojtjen e të drejtave tuaja nga marrëdhënia e punës;
- ✓ Paraqitja e ankesave në Këshillin Inspektues për mbikëqyrjen e punës së inspektorëve të punës pranë ISHT.

## KONTAKTONI INSPEKTORATIN SHTETËROR TË PUNËS (ISHT)

Bul. Partizanski odredi Nr. 48A – Shkup  
Telefoni kontaktues: +38923224504;  
Posta elektronike/e-mail: info@dit.gov.mk  
Sektori për mbikëqyrje inspektuese në fushën e marrëdhënieve të punës



Telefon për kontakt: Zyra Qendrore +38923224504  
Sektori për mbikëqyrje inspektuese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

### Telefonat e kontaktit:

Rajoni 1 - Shkup: +38975402875

Rajoni 2 - Kumanovë, Probishtip, Shtip, Koçani, Veles, Kavadar, Negotinë, Gjevgjeli, Strumicë, Dellçevë, Vinicë: +38975402868

Rajoni 3 - Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Strugë, Ohër, Resnjë, Manastir, Prilep: +389075402863

## TË DREJTOHESH TE AVOKATIT TË POPULLIT

Avokati i Popullit është kompetent të veprojë në rastet e shkeljeve të procedurës para organeve të administratës shtetërore dhe në organet dhe organizatat që kanë kompetenca publike, si:

- ◆ rivendosje në kundërshtim me sistematizimin e vendeve të punës,
- ◆ shkelja e procedurës së përzgjedhjes dhe punësimit,
- ◆ shkelje e rregullave të përcaktuara për procedurat e brendshme,
- ◆ mospagesa e kontributeve për sigurimin shëndetësor, pensional dhe invalidor

Rr. Maqedonia Nr.19 - Shkup. Tel kontakti: +38923129335;  
Posta elektronike/e-mail: contact@ombudsman.mk

„Gjithkush ka të drejtën e punës, zgjedhjen e lirë të punësimit, mbrojtjen gjatë punës dhe siguri materiale gjatë papunësisë së përkohshme. Çdo punë është e disponueshme për të gjithë, në kushte të barabarta. Çdo punonjës ka të drejtë për fitim adekuat. Çdo punonjës ka të drejtën e pushimit të paguar ditor, javor dhe vjetor. Punonjësit nuk mund të heqin dorë nga këto të drejta“.

- Neni 32 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut



Ministero degli Affari Esteri  
e della Cooperazione Internazionale



Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë. Përmajtja e botimit është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk shpreh domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë.

# SIGURIA E PUNËS - PUNËTORË PRODUKTIVE

INFORMACIONE PËR QASJEN NË NDIHMËN JURIDIKE TË DEDIKUAR PËR PUNËTORE DHE PUNËTORE - MEKANIZMA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE



Gjatë punësimit ose vazhdim të një marrëdhënie pune me afat të caktuar, vallë a keni marrë një kopje të kontratës së punës apo një kopje të aneksit të kontratës?

Në momentin e punësimit, vallë keni marrë një kopje të kërkesës për sigurim të detyrueshëm social?

Vallë mban punëdhënësi të dhëna për punën jashtë orarit, punën në festa, lëndimet në vendin e punës, pushimet vjetore?

Vallë punëdhënësi ju ka ofruar trajnime për shëndetin dhe sigurinë në punë?

Vallë ju detyron punëdhënësi të përdorni ditët e pushimit vjetor në vend të ditëve të sëmundjes?

Vallë jeni përballur me ndonjë lloj ngacmimi seksual apo psikologjik në vendin e punës (mobingu)?

Gjatë themelimit ose gjatë marrëdhënies së punës, vallë ju janë dhënë të nënshkruani ndonjë lloj dokumentesh, përmbajtja e të cilëve konsideroni se është në dëm të tuaj (dorëheqje kontraktuale të kushtëzuara, deklarata të njëanshme me të cilat hiqni dorë nga përdorimi i ndonjë të drejte etj).

Vallë keni kontaktuar ndonjëherë me Inspektoratin Shtetëror të Punës apo vallë dini për një inspektim të jashtëzakonshëm ndaj punëdhënësit tuaj?

Vallë keni kryer ndonjë procedurë të brendshme para punëdhënësit për të mbrojtur të drejtat tuaja të punës të rregulluara me kontratën e punës ose kontratën kolektive?

A keni zhvilluar ndonjë procedurë gjyqësore për të mbrojtur të drejtat tuaja të punës?

## REKOMANDIME THEMELORE GJATË KRIJIMIT TË NJË MARRËDHËNIE PUNE

Kur punësoheni, nga punëdhënësi juaj detyrimisht duhet të merrni

- ✓ kontratë për punësim dhe
- ✓ kopje të kërkesës për sigurim të detyrueshëm social



## INSPEKTORATI SHETËROR I PUNËS

Mbrojtja institucionale e të drejtave nga marrëdhënia e punës, qytetarët e arrijnë përmes Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP).

Kërkesa mund të paraqitet me shkrim ose verbalisht me deklaratë të dhënë para inspektorit të punës. Iniciativa për fillimin e inspektimit mund të paraqitet në mënyrë anonime ose përmes një shoqate të autorizuar për ndihmë juridike falas. Inspektori është i detyruar të veprojë për çdo iniciativë të paraqitur në afat prej 30 ditësh dhe ta informojë paraqitësin e iniciativës për gjendjen e krijuar.

Kur inspektori i punës konstaton se është shkelur ose penguar ushtrimi i së drejtës së qytetarit që ka paraqitur kërkesën, në përputhje me ligjin, do të vendosë masat përkatëse të inspektimit, me qëllim për të eliminuar parregullsitë që kanë sjellë shkeljen ose pengimin e të drejtës. Në rast të tillë, inspektori do të nxjerrë një vendim me të cilin urdhëron punëdhënësin të ndërmarrë veprimet e duhura brenda një periudhe të caktuar kohore që të eliminohen parregullsitë e konstatuara.

Për sa i përket pyetjes vallë jeni të detyruar të kryeni procedurë të brendshme para punëdhënësit apo mund të kërkonti drejtpërdrejt mbrojtje gjyqësore. varet nëse bëhet fjalë për çështje statusore, pra për shkelje të të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës, apo bëhet fjalë kërkesa parash nga marrëdhënia e punës.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme edhe në fushën e afateve ligjore që duhet të i respektoni gjatë ndërmarrjes të veprimeve të duhura për të mbrojtur të drejtat tuaja të punës.

## ÇËSHTJET E STATUSIT NGA MARRËDHËNIA E PUNËS

(shkelja e të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale/zgjidhja e kontratës së punës)

Nëse mendoni se punëdhënësi:

- ◆ nuk ju siguron të drejtat nga marrëdhënia e punës;
- ◆ nëse ka shkelur ndonjë nga detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës ose nga kontrata kolektive, keni të drejtë të i parashtroni **kërkesë me shkrim punëdhënësit** të e heqë dëmtimin, ose të e përmbush detyrimin e tij.

Punëdhënësi është i detyruar që brenda 8 ditëve nga dita kur keni paraqitur kërkesën me shkrim, të përmbushë detyrimet e tij, pra të e heqë dëmtimin.

Vendimi me shkrim me të cilin ndërpritet marrëdhënia e punës suaj, duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë një udhëzim ligjor për autoritetin tek i cili duhet të paraqisni një kundërshtim.

Kundër vendimit me shkrim për anulimin e kontratës së punës keni të drejtë të **kundërshtoni** brenda **8 ditëve**, nga dita e marrjes së vendimit. Në kundërshtim, detyrimisht duhet të specifikoni:

- ◆ Të dhënat tuaja personale;
- ◆ Të dhëna për punëdhënësin;
- ◆ Theksim të vendimit kundër të cilit parashtroni kundërshtim;
- ◆ Shpjegim të arsyeve për të cilat parashtroni kundërshtimin;
- ◆ Propozim që vendimi me shkrim të shfuqizohet ose nulohet; dhe
- ◆ Data, vendi dhe nënshkrimi juaj

Punëdhënësi ka detyrimin të marrë vendim brenda **8 ditëve** nga marrja e kundërshtimit. Nëse punëdhënësi nuk merr vendim brenda afatit të caktuar ose merr vendim me të cilin nuk jeni të kënaqur, keni të drejtë të paraqisni padi në gjykatën kompetente brenda **15 ditëve**.

## NGACMIMET NË VENDIN E PUNËS – MOBINGU

Mobingu mund të manifestohet në mënyra të ndryshme, si për shembull, tallje dhe nënçmim të vazhdueshëm në vendin e punës, imponim të detyrave poshtëruese të punës dhe/ose të bërtitura e fyerje të vazhdueshme, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë sulmohet dinjiteti i punëtorit.

Nëse besoni se jeni viktimë e mobingut, mund të filloni procedurën duke i paraqitur një kërkesë me shkrim personit që e kryen mobingun, në afat brenda **6 muajve** nga dita kur është kryer për herë të fundit akti i mobingut.

Kërkesa për mbrojtje kundër ngacmimit në vendin e punës (mobingut) duhet të përmbajë:

- ◆ Të dhënat për parashtruesin e kërkesës;
- ◆ Të dhëna për punonjësin, i cili konsiderohet se po e bën ngacmimin;
- ◆ Një përshkrim i shkurtër i sjelljes që me të drejtë konsiderohet se përbën mobing;
- ◆ Kohëzgjatja dhe shpeshtësia e sjelljeve që konsiderohen si mobing;
- ◆ Data kur për herë të fundit është kryer ajo sjellje;
- ◆ Dorzimi i fakteve dhe provave, dhe
- ◆ Paralajmërim se nëse sjellja e tillë nuk ndërpritet menjëherë, parashtruesi do të detyrohet të kërkojë mbrojtje ligjore.



## KËRKESA PARASH NGA MARRËDHËNIA E PUNËS

Nëse punëdhënësi nuk ju ka paguar:

- ◆ paga,
- ◆ kontributet për sigurimin social,
- ◆ shtesa të tjera pagës,



ju mund të bëni padi drejtpërdrejt në gjykatën kompetente pa i paraqitur më parë një kërkesë me shkrim punëdhënësit. Ju mund të bëni padi brenda 3 viteve nga dita kur punëdhënësi është detyruar t'ju paguajë pagat, kontributet dhe/ose kompensimin e pagës.